



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 25.3.2024

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 681, datë 7.7.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Ismajlukaj

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 19.9.2023 dhe parashtrimeve me shkrim të depozituara në seancën gjyqësore të datës 29.2.2024, në mënyrë të përmbledhur, vlerëson se:

1. *Për shkakun ankimor lidhur me gjetjet në kontrollin e kriterit të figurës*

1.1 Komisioneri Publik, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, vlerëson se mbeten të provuara dhe të dokumentuara rrethanat e rezultuara nga kontrolli i figurës, të trajtuara në ankimin e Komisionerit Publik, përmbajtjen e Gjetjes të paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes, si dhe Rekomandimi i ONM-së, konkretisht:

(i) Nga baza e të dhënave TIMS rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit, më datë ** janar 2017, ora 11:13, ka kaluar kufirin shqiptar me një mjet¹ në pronësi të shtetasit ***. ***. dhe i drejtuar nga shtetasi ***. ***. Shtetasi ***. ***, bazuar në burime të hapura të informacionit, ka rezultuar një emër i njohur nga drejtësia shqiptare, i shpallur fajtor më 3 janar të vitit 2016, nga Gjykata e Riminit - Zyra G. I. P. (në Itali), për 5 akuza për shitje të paligjshme

¹ Me targë ***.

të lëndëve narkotike² dhe një akuzë për armëmbajtje pa leje, duke u dënuar me 4 vjet e dy muaj burgim dhe gjobë prej 26.000 euro.

(ii) Aktiviteti penal për të cilin është dënuar shtetasi ***. ***. shtrihet midis periudhës 2013-2014, pavarësisht se përgjegjësia penale e tij është përcaktuar me vendim të formës së prerë në vitin 2016. Në këto rrethana, për shkak të pozitës së subjektit, kontakteve dhe njohjeve të tij të ngushta në Tropojë, nuk duken bindëse pretendimet e subjektit se nuk ka qenë në dijeni të ngjarjeve që lidhen me shtetasin ***. ***. Gjithashtu, nga aktet, ka rezultuar se me këtë automjet kanë udhëtuar dhe shtetas të tjerë, me të cilët subjekti i rivlerësimit rezulton se ka lidhje familjare dhe shoqërore, shtetasit ***. ***. dhe ***. ***., të deklaruar nga vetë subjekti në përgjigjet e Pyetësorit nr. 3. Po ashtu, rezulton se me automjetin e mësipërm ka udhëtuar dhe shtetasi ***. ***., djali i xhaxhait të subjektit.

1.2 Sa më sipër, Komisioneri Publik, për sa trajtuar në shkaqet e ankimit edhe në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së dhe të jurisprudencës së Kolegjit, çmon se këto rrethana, të analizuar së bashku dhe në raport me njëra-tjetrën, tregojnë për një sjellje dhe qëndrim të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, të papranueshëm për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Rrethanat e dala nga kontrolli i figurës, ndonëse nuk çojnë në kualifikimin e subjektit, si të papërshtatshëm në kuptim të këtij kriteri, të marra së bashku me rrethanat e tjera, të trajtuara gjerësisht në ankimin e datës 19.9.2023 dhe në Rekomandimin e ONM-së, tregojnë mjaftueshëm elemente që vijnë në kundërshtim me vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, në funksion të mbrojtjes dhe forcimit të besimit të publikut, duke krijuar kështu premisat e duhura për një vlerësim tërësor nga Kolegji, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

2. Për shkakun ankimor trajtuar në “Gjetje të tjera”

2.1 Nga aktet e administruara, rezulton se Komisioni, gjatë hetimit administrativ shtesë, sipas informacionit të administruar nga organet ligjzbatuese, nga të cilat është njohur lidhur me “Fenomenin e kultivimit të *cannabis sativa* në vend”, ka hetuar edhe për disa shtetas, konkretisht shtetasit: (i) ***. ***.; (ii) ***. ***.; (iii) ***. ***.; (iv) ***. dhe ***. ***. dhe (v) ***. ***.³

2.2 Komisioni, bazuar dhe në të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS, ka konstatuar shoqërimin e subjektit me persona të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme dhe të dënuar për vepra penale, duke i vlerësuar fillimisht si situata të cilat ndikojnë negativisht dhe cenojnë standardet e sjelljes së magjistratit, etikën e tij në punë dhe angazhimin ndaj vlerave, referuar ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, për të cilat i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, trajtuar gjerësisht në shkaqet e ankimit të datës 19.9.2023 dhe në seancën gjyqësore të datës 29.2.2024.

² Prodhimi, shitja dhe trafikimi i narkotikëve janë vepra penale të parashikuara në nenet 283 dhe 283/a të Kodit Penal, të cilat të dyja përfshihen në listën e veprave penale të parashikuara nga neni 3, pika 1 e ligjit nr. 10192/2009, të cilit i referohet neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, për të përcaktuar kategorinë e “personave të përfshirë në krimin e organizuar”.

³ Nuk rezulton që subjekti të ketë udhëtuar me këtë shtetas. Sipas të dhënave në TIMS nuk ka rezultuar të ketë ndonjë shkelje të ligjit nga ky shtetas. Referuar sistemit TIMS, z. *** *** ka udhëtuar me automjetin me targa *** , gjatë periudhës 2013 – 2014, në pronësi të shtetasit *** ***.

2.3 Komisioni ka hetuar lidhur me një automjet të tipit *BMW*, për të cilin ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e ka përdorur vetëm një herë. Ky automjet (***) ka qenë në pronësi të shtetasës ***, ***, me përdorues ***, ***, dhe ***, ***, vëllezërit e subjektit të rivlerësimit⁴. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se ky automjet është përdorur gjithashtu dhe nga shtetasi ***, ***. Po ashtu, nga sistemi TIMS, rezulton se subjekti ka udhëtuar dhe ka përdorur automjetin me targë ***, i llojit “Seat”, në pronësi të shtetasit ***, ***, automjet me të cilin rezulton se ka udhëtuar dhe shtetasi ***, ***.

2.4 Komisioni ka administruar informacion nga Prokuroria Tropojë⁵ dhe Gjykata Tropojë⁶, të cilat kanë informuar se janë evidentuar kallëzime penale të regjistruara dhe procedime penale, në ngarkim të shtetasit ***, ***, ndër të tjera⁷, dhe procedimi penal nr. ***, i vitit 2012, për veprën penale “Plagosje e rëndë nga pakujdesia” dhe “Mbajtja pa leje të armëve dhe municionit luftarak”, të parashikuar nga nenet 91 dhe 278/2 të K. Penal. Subjekti i rivlerësimit, në këtë procedim penal, ka vepruar në cilësinë e Oficerit të Policisë Gjyqësore, ka hartuar procesverbalin për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, si dhe procesverbalin për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale (kallëzuesi), si dhe dëshmitarët.

2.5 Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar se *veprimet e subjektit të rivlerësimit, të konfirmuara edhe nga vendimi i Gjykatës⁸, provojnë se ky i fundit është sjellë në përputhje me etikën e Oficerit të Policisë Gjyqësore, zbatimin korrekt të ligjit dhe shmangien e konfliktit të interesit.*

2.6 **Komisioneri Publik**, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, si dhe rezultateve të hetimit, vlerëson se dhe në rastin e mësipërm, hetimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit, në kushtet e ekzistencës së marrëdhënies miqësore, në kufijtë e pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, është një sjellje, e cila, më së paku, ndikon në perceptimin negativ të qytetarëve në integritetin, përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e organeve të drejtësisë. Ky element, në tërësi me rastet e tjera të rezultuara, qoftë edhe në mungesë të konfliktit të interesit, ndikon në cenimin e imazhit të organit që përfaqëson akuzën në emër të shtetit ndaj shkelësve të ligjit, çka bën që ndaj subjektit të rivlerësimit të rëndojë edhe parashikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

2.6.1 Pretendimet e subjektit, lidhur me njoftimin e drejtuesit të Prokurorisë apo prokurorin e çështjes, se kishte njohje me shtetasin ***, ***, mbeten në nivel deklarativ, pasi nga aktet,

⁴ Nga regjistri i gjendjes civile rezulton se ***, ***, dhe ***, ***, janë vëllezërit e subjektit të rivlerësimit. Ky automjet ka qenë në pronësi të shtetasës ***, ***, për periudhën 2013 – 2016. Pas këtij viti, ky mjet ka kaluar në pronësi të shtetasve të tjerë, me të cilët nuk rezulton që subjekti të ketë udhëtuar.

⁵ Me shkresën nr. ***/** prot., datë ***.2.2023.

⁶ Me shkresën nr. ***/** prot., datë ***.3.2023.

⁷ Procedimi penal nr. ***, i vitit 2005, regjistruar për veprat penale “Vrasje me paramendim mbetur në tentativë”, “Shkatërrim prone me eksploziv dy herë”, “Mbajtje pa leje të lëndëve plasëse”, të parashikuar nga nenet 78-22, 152, 278/2 të K. Penal (dëmtim i lokalit të shtetasit ***, ***), dosje e pezulluar.

⁸ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr. ***, datë ***.12.2012, ka vendosur: 1. Pushimin e çështjes penale për veprën penale “Plagosje e rëndë nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 91 i K. Penal, për shkak se kjo vepër penale ishte amnistuar me ligjin nr. 107/2012, datë 8.11.2012, shpallur me dekretin nr. 7824, datë 19.11.2012, të Presidentit të Republikës. 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit ***, ***, për veprën penale “Mbajtja pa leje të armëve dhe municionit luftarak”, parashikuar nga neni 278/2 të K. Penal, dhe dënimin e tij me 10.5 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406, të K. Penal, i pandehuri dënohet përfundimisht me 7 muaj burgim... Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën ***.12.2012.

edhe pas shqyrtimit gjyqësor, nuk duket se subjekti i rivlerësimit ka sjellë ndonjë dokument provues.

2.6.2 Komisioni, në analizë të të dhënave të sistemit TIMS, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka dy dalje⁹, edhe me automjetin me targa ***, në pronësi të shtetasit ***. ***, ndërkohë që rezultoi se ky shtetas ka hyrje në Shqipëri në të njëjtën datë. Po ashtu, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka 1 udhëtim¹⁰ me automjetin me targa ***, në pronësi po të këtij shtetasi. Nga aktet rezultoi se ky automjet ka qenë në pronësi të shtetasit ***. ***, dhe përdorues ***. ***, nga viti 2011 - 2016. Nga hetimi ka rezultuar se me automjetin me targë *** ka udhëtuar¹¹dhe shtetasi ***. ***.

2.7 Lidhur me shtetasin ***. ***, Prokuroria Tropojë ka informuar Komisionin se në ngarkim të tij, ndër të tjera,¹² është regjistruar dhe procedimi penal nr. ***, i vitit 2007, për veprat penale “Kontrabanda me mallra të tjera”, në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 174-25 të K. Penal, në ngarkim të pandehurve ***. ***, dhe ***. ***, dosje e gjykuar. Nga aktet ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e Oficerit të Policisë Gjyqësore (OPGJ-së), është përfshirë në veprimet hetimore të këtij procedimi. Subjekti i rivlerësimit ka hartuar dhe nënshkruar disa akte procedurale¹³.

2.8 Lidhur me shtetasin ***. ***, Komisioni ka kërkuar informacion pranë Dr. së Përgjithshme të Burgjeve, për gjendjen gjyqësore¹⁴, nga ku ka rezultuar se ky shtetas ka qenë i dënuar për disa vepra penale: të mashtrimit, të largimit të dënuarit nga vendi i ngjarjes, të drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt, mosbindjes ndaj urdhrit të punonjësit të Policisë së rendit publik, vjedhje, përvetësim të titullit apo detyrës shtetërore, si dhe vjedhje me dhunë. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit shpesë, lidhur me këtë shtetas, ka prapësuar se nga aktet e hetimit administrativ nuk gjendet asnjë lidhje apo kontakt i drejtpërdrejtë me të.

2.9 Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar se, gjatë vitit 2016, ka pasur në përdorim automjetin në pronësi të shtetasit ***. ***, me targë ***. Në përgjigjet e Pyetësorit 3, më datë 23.11.2022, subjekti i rivlerësimit deklaroi se me shtetasit ***. ***, dhe ***. ***, ka lidhje familjare. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve¹⁵ ka informuar se shtetasi ***. ***, ***, me vendimin nr. ***, datë ***.2.1992, të Gjykatës Tiranë, është deklaruar fajtor për veprën penale të “Vjedhjes së Pasurisë Shtetërore”...

⁹ Referuar rezultateve të hetimit dhe sistemit TIMS të administruar në dosje të Komisionit, të dhënat i përkasin datës ***.2.2014 dhe datës ***.12.2013.

¹⁰ Referuar TIMS, datë ***.12.2013.

¹¹ Datë ***.6.2012.

¹² (ii) Procedimi penal nr. ***, i vitit 2010, regjistruar për veprën penale “Shkatërrim i pronës”, të parashikuar nga neni 150 i K. Penal, në ngarkim të pandehurit *** ***, me kallëzues shtetasin ***. ***, dosje e gjykuar; si dhe (iii) Mosfillimi i procedimit penal nr. ***, i vitit 2019, referuar për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, të parashikuar nga neni 150 i K. Penal, në ngarkim të shtetasit ***. ***.

¹³ “Procesverbalin e Pyetjes së Pandehurit”, të datës ***.10.2007; Procesverbalin për Njohjen e të Pandehurit me materialet e çështjes”, të datës ***.10.2007; “Procesverbalin për dorëzimin e provës materiale të përfituar nga shitja”, datë ***.10.2007; “Procesverbalin për shitjen e provës materiale”, datë ***.10.2007; “Procesverbalin për lënien në ruajtje në bankë të vlerës monetare të sekuestruar”. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr. ***, datë ***.12.2007, ka gjetur fajtor dhe dënuar shtetasin ***. ***, dhe një shtetas tjetër për veprën penale të “Kontrabandës me mallra të tjera në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 174-25 të K. Penal. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën ***.12.2007.

¹⁴ Referuar shkresës nr. ***/***, datë ***.6.2023.

¹⁵ Referuar shkresës me nr. *** prot., datë ***.3.2023.

2.9.1 Nga aktet rezulton se me automjetin në pronësi të shtetasit ***. ***, me targë ***, ka udhëtuar dhe shtetasi ***. ***. Subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar me këtë shtetas me automjetin në përdorim të tij, me targa ***, në pronësi të shtetasit ***. ***, në datën ***.9.2016. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve¹⁶ ka informuar se shtetasi ***. ***, me vendimin nr. ***, datë ***.1.2007, të Gjykatës Tropojë, është deklaruar fajtor për veprat penale të *“Plagosjes së Lehtë me Dashje”* dhe *“Plagosjes së lehtë me dashje të kryer në bashkëpunim...”*, si dhe me vendimin nr. ***, datë ***.7.2008, të Gjykatës Tropojë, është deklaruar fajtor për veprën penale të *“Goditje për shkak të detyrës kryer në bashkëpunim...”*.

2.10 Komisioni, pasi ka vlerësuar shpjegimet e subjektit, në përfundim të sa më sipër, ndër të tjera, ka vlerësuar se: *[...] në analizim të të gjitha rrethanave të mësipërme, si dhe fakteve të parashtruara nga subjekti, të dhënat e rezultuara nga hetimi i çështjes janë të pamjaftueshme, për të konkluduar se subjekti ndodhet në kushtet e “cenimit të besimit të publikut” dhe ndaj tij duhet të aplikohet masa e shkarkimit nga detyra... Për këtë arsye, konstatimet e Komisionit në lidhje me sjelljen e subjektit të rivlerësimit jashtë ushtrimit të funksionit, të parashikuara në nenin 103 e vijues të ligjit nr. 96/2016, do t'i përcillen për kompetencë ILD-së për vlerësime të mëtejshme, për të vlerësuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi lidhur me subjektin e rivlerësimit Artur Ismajlukaj [...].*

2.11 Komisioneri Publik, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, si dhe rezultateve të hetimit, vlerëson se hetimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit, në kushtet e ekzistencës së marrëdhënies miqësore, në kufijtë e pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, është një sjellje, e cila, më së paku, ndikon në perceptimin negativ të qytetarëve në integritetin, përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e organeve të drejtësisë. Ky element, në tërësi me rastet e tjera të rezultuara, qoftë edhe në mungesë të konfliktit të interesit, ndikon në cenimin e imazhit të organit që përfaqëson akuzën në emër të shtetit ndaj shkelësve të ligjit, çka bën që ndaj subjektit të rivlerësimit të rëndojë edhe parashikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

2.12 **Komisioneri Publik**, duke vlerësuar në tërësi vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, çmon se në rastin konkret rezultojnë disa rrethana dhe fakte, që për nga shpeshësia dhe kohëzgjatja e tyre, nuk mund të jenë rastësore, e që më së paku, tregojnë për një qëndrim neglizhent dhe jo të kujdesshëm të subjektit të rivlerësimit për ambientin dhe personat që e rrethojnë. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se shtetasit me të cilët ka udhëtuar subjekti i rivlerësimit apo ka lidhje familjare apo shoqërore subjekti i rivlerësimit, janë shkelës të ligjit dhe të dënuar, fakt i cili, në sytë e një vëzhguesi të jashtëm, ngre pikëpyetje mbi integritetin dhe besimin e subjektit të rivlerësimit apo ndikimin që këta persona, në forma dhe mënyra të ndryshme, mund të kenë tek ai.

2.13 **Komisioneri Publik**, në konsideratë edhe të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se në këto rrethana përfshihen problematika jo vetëm mbi udhëtimet e përsëritura me automjetet e personave me probleme me drejtësinë, por dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi normalitetin e kësaj situatë, sipas të cilit, *për shkak të lidhjeve familjare dhe shoqërore, jetesës*

¹⁶ Referuar shkresës me nr. *** prot., datë ***.3.2023.

për një kohë shumë të gjatë në të njëjtin komunitet, është më se e rëndomtë që të krijohen kontakte të rastësishme me persona të vlerësuar nga Komisioni si të papërshtatshëm.

2.14 Në përfundim, **Komisioneri Publik**, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit¹⁷, e gjen të padrejtë dhe jo bindës konkluzionin e Komisionit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu transferimin e çështjeve për inspektim pranë organit kompetent, ILD-së, duke i nxjerrë kështu jashtë juridiksionit të rivlerësimit, për sa kohë rezultojnë një sërë rrethanash që duhen vlerësuar në kuptimin tërësor të procedurave të parashikuara nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi mbeten të provuara situata, të cilat ndikojnë negativisht dhe cenojnë standardet e sjelljes së magjistratit, etikën e tij në punë dhe angazhimin ndaj vlerave, referuar ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

3. Komisioneri Publik, në konsideratë edhe të Rekomandimit të ONM-së dhe të rezultateve të hetimit mbi kontrollin e kriterit të pasurisë, ashtu sikurse trajtuar gjerësisht dhe në ankimin e datës 19.9.2023, vendos në vëmendje të Kolegjit edhe rrethanat e dala nga kontrolli i kriterit të pasurisë, lidhur me mospërputhjen e deklarimeve të subjektit mbi burimet e krijimit të pasurisë “apartament me sip. 96,2 m²”, transaksionet, si dhe lidhjet familjare të subjektit me shtetasin ***. ***. ***., që, nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka rezultuar i rehabilituar, pasi me vendimin nr. ***, datë ***.3.1999, të Gjykatës Tropojë, është deklaruar fajtor për veprën penale të “Përvetësimit të Pasurisë Shtetërore në bashkëpunim”... si dhe veprës penale të “Armëmbajtjes pa leje”...

Kërkimi përfundimtar i ankimit

4. Në përfundim, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 19.9.2023, parashkrimeve me shkrim të depozituara në seancën gjyqësore të datës 29.2.2024, si dhe Rekomandimit të ONM-së;

5. Bazuar në sa më sipër referuar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, dhe në një vlerësim tërësor të procedurave, ndodhet në kushtet e aplikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016;

6. Komisioneri Publik, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 681, datë 7.7.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Ismajlukaj.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO

¹⁷ Shihni vendimin (JR) nr. 2/2020, paragrafët 15.2 deri 15.7, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.